



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

DATË/A:	18.06.2015
REFERENC-Ë:	AKK-DPKPP
PËR/ZA/TO:	z. Jetulla Kabashi Shef i Zyrës së Prokurimit në Komunën e Rahovecit
CC:	z. Idriz Vehapi Kryetar i Komunës së Rahovecit
NGA/OD/FROM:	<i>ner</i> z. Hasan PRETENI <i>Am e</i> Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me Tenderin me titull " Ndriçimi publik dhe mirëmbajtja e rrjetit ekzistues në Komunën e Rahovecit "



I nderuari z. , Kabashi

Në mbështetje të nenit 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.12 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit dhe nenit 19 paragrafi 1 nën paragrafi 1.6 të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, lidhur me Tenderin : " **Ndriçimi publik dhe mirëmbajtja e rrjetit ekzistues në Komunën e Rahovecit**" me numër prokurimi: 623 15 006 521 Agjencia kundër Korrupsionit, ofron këtë:

OPINION

Me të cilin kërkohet nga ju si Autoritet Kontraktues që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme për evitimin e shkeljeve të evidentuara në lidhje me Tenderin " **Ndriçimi publik dhe mirëmbajtja e rrjetit ekzistues në Komunën e Rahovecit**" me numër prokurimi: 623 15 006 521, në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit nr. 04-L/042 për Prokurimin Publik.

A r s y e t i m

Komuna e Rahovecit si Autoritet kontraktues, përmes zyrës së Prokurimit ka përgatitë njoftimin për kontratë me titull **Ndriçimi publik dhe mirëmbajtja e rrjetit ekzistues në Komunën e Rahovecit**" me numër prokurimi: 623 15 006 521, e cila është publikuar në faqen elektronike të KRPP-së me dt.21.04.2015 në Procedurë të Hapur. Agjencia kundër Korrupsionit, sipas detyrës zyrtare ka identifikuar këtë procedurë të prokurimit si lëndë për trajtim. Gjatë trajtimit dhe ekzaminimit të dokumentacionit lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, Agjencia kundër Korrupsionit ka hasur në disa të dhëna të cilat janë në kundërshtim me Legjislacionin në fuqi i cili e rregullon fushën e Prokurimit Publik në Republikën e Kosovës.

Në njoftimin për kontratë i cili është publikuar në faqen elektronike të KRPP-së, me datë 21.04.2015 tek rubrika III.2.4) Kapaciteti teknike dhe profesionale pika 5. **Ka kërkuar të gjitha produktet duhet të jenë Made in EU 100%**, kërkesë kjo e cila konsiderojmë se bien ndesh me Legjislacionin në fuqi për Prokurimin Publik.

Po ashtu gjatë ekzaminimit të dokumentacionit për këtë aktivitet të prokurimit, tek pjesa e specifikimeve teknike të detyrueshme në dosjen e tenderit AKK ka vërejtur se tek disa pozicione të specifikimeve teknike është kërkuar që produktet duhet të jenë prej vendeve të EU.

Bazuar në legjislacionet në fuqi për Prokurim Publik me përcaktimin e origjinës të këtyre mallrave, mund të favorizohen prodhuesit e caktuar dhe në të njëjtën kohë diskriminohen prodhuesit tjetër. Autoriteti Kontraktues mund të kërkojë që produkti të jetë i kualitetit të lartë dhe mund ti referohet një standardi vendor, European ose ndërkombëtar, por nuk lejohet assesit të kërkojë që origjina e këtyre pajisjeve të jetë nga ndonjë vend i caktuar si.

Më datë 01.06.2015 përmes ueb faqes elektronike të KRPP-së Autoriteti Kontraktues publikon Njoftimin për Anulimin e Aktivitetit të Prokurimit me arsyetimin si në vijim: ***Një dispozitë në Ligjin e Prokurimit Publik kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit(janë pranuar më pak se 2 tenderë të përgjegjshëm apo kërkesa për pjesëmarrje)***

Veprimet e Autoritetit Kontraktues konsiderojmë se bien ndesh me nenin 28 Specifikimet teknike, nenin 69 Aftësia Teknike dhe Profesionale të Ligjit për Prokurimin Publik Nr.04/L-042,dhe nenin 23 Kriteret e Përzgjedhjes të Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik.

Konsiderojmë se shkelje të tilla, nuk duhet lejuar në procedura të prokurimit, andaj AKK kërkon nga Autoriteti Kontraktues që të shmang praktikat e tilla në të ardhmen.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

Me respekt !